



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 30/2 Prot.

Tiranë, më 5 / 4 /2018

V E N D I M

Nr. 101 , Datë 5 / 4 /2018

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 03, datë 09.01.2018, të paraqitur nga subjektet ankues, A.B kundër M.B¹ dhe B.L, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të lidhjes familjare² dhe E.I kundër M.B dhe B.L, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të vendlindje. E.I nëpërmjet Prokurës të Posaçme, nr. 139 Rep, nr. 27/4 Kol, datë 12.01.2018 ka dhënë kompetencën për tu përfaqësuar nga bashkëshorti A.B. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve.

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës dhe në shkresën datë 15.01.2018, subjektet ankuese në mes të tjerash kanë deklaruar se: *“E gjithë vazhda e publikimeve shpifëse, fyese, diskriminuese dhe denigruese ndaj tij dhe bashkëshortes së tij kanë nisur menjëherë pas kërkesës të paraqitur nga Prokuroria për Krime të Rënda pranë Komisionit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në datë 19.10.2017 për dhënien e autorizimit për deputetin z. Saimir Tahiri. Pas këtij momenti menjëherë ka filluar një valë e paprecedent publikimesh, me motive të thella racizmi dhe ksenofobie ndaj ankuesve dhe kjo vetëm për faktin e origjinës krahinore nga Tropoja, dhe shoqërimit të supozuar me ish Kryeministrin Berisha”*.

Subjekti ankues, informon se në artikujt e publikuar në Gazetën “Tema” dhe në portalin e gazetës online, në datë 21.10.2017, në artikullin: “Prokurorët Tropojanë, kushërinj të Berishës, duan arrestimin e Tahirit” shkruhet mes të tjerash se: *“E.I nga Tropoja, është pjesëtare e grevës së urisë të Sh.B në vitin 1999. Gruaja e A.B, kushëri i dytë i Sh.B. G.O nga Tropoja....”*. Po në datë 21.10.2017, në artikullin: “Kushërinjtë e Saliut kundër kushërinjve të Sajmiri”, me autor M.B, në mes të tjerash shkruhet se: *“...e kupton se përse kanë shkuar në atë seancë tre prokurorë, të tre nga Tropoja, me lidhje politike e fisnore me Sali Berishën..... Kjo është*

¹ M.B, në cilësinë si, Drejtor/Botues dhe B.L në cilësinë si Kryeredaktor të gazetës Tema.

² Referuar Procesverbalit datë 12.01.2018, në lidhje me shkakun e pretenduar, A.B, vendlindja Tropojë, është bashkëshorti i E.I, vendlindja Tropojë, me detyrë Prokurore pranë Prokurorisë për Krime të Rënda.

komedia e fundit e drejtësisë politiko-tropojane, që shkatërroi sistemin e drejtësisë në vend..... Është e pazakontë se si në një seancë dëgjimore, ti mund të shikosh fytyrën reale të drejtësisë së Berishës jo vetëm nga boshllëku intelektual, korruptimi politik, por dhe pamjen vizive dhe fjalorin e saj”. Në datë 22.10.2017, në artikullin: “Lidhjet me Berishën dhe njolla e zezë e bashkëshortit” në mes të tjerash shkruhet se: “... Bashkëshorti i saj ka qenë kandidat për deputet i PD-së. Jo vetëm kaq, por sipas një burimi të gazetës TemA, ai ka edhe një “njollë të zezë”, e cila me sa duket i është hequr në Shqipëri me ndihmën e bashkëshortes....”. Në datë 22.10.2017 në artikullin: “Nga emri në listën e zezë të SHBA-së, tek ngelja: Ja pse tre prokurorët e Tahirit, janë jo vetëm “kushërinjtë” por edhe të “paaftë”, në mes të tjerash shkruhet se: “Sipas informacioneve, në total janë angazhuar 6 prokurorë të Krimeve të Rënda, por 3 janë më kryesorët: B.H; E.Y dhe G.O.....E përbashkëta kryesore e 3 emrave është se të 3 janë nga Tropoja, vendlindja e ish-kryeministrit Sali Berisha.....Edhe dy prokurorët e tjerë kanë lidhje me Berishën, por kanë edhe ‘njolla’ të tjera në karrierën e tyre, që tregon deri diku edhe paaftësinë e tyre. Si E.I, ashtu dhe G.O, kanë qenë ndër nxënësit më të dobët në shkollën e Magjistraturës, nuk është për tu habitur që cilësia e akt-akuzës linte shumë për të dëshiruar.....Nga ana e saj, E.I, gjithashtu është renditur në fundin e renditjes së vitit shkollor 2004-2005, duke qenë e 19-ta nga 24 pjesëmarrës”. Në datë 25.10.2017 në artikullin: “Burri i prokurores së Tahirit, i përfshirë në trafik prostitucioni në Itali e Belgjikë. Vrau vëllanë e ish të fejuarës, pse i tregoi....”, në mes të tjerash shkruhet se: “.....I.H, duke ironizuar ‘qytetarin digjital’ka publikuar disa të dhëna për bashkëshorten e prokurores E.Y..... Dua të tregoj se burri i prokurores E.I, A.B, së bashku me dëshmitarin e gjyqit të Hajdarit, tropojanit A.M, kanë punuar bashkë në trafikun e prostitutave në Itali e më pas në Belgjikë.....A.B përpara se të njihej me E.I, ka qenë i fejuar me një vajzë nga Tirana, por kur i vëllai i të fejuarës ka marrë vesh se ai merret me trafik femrash, i ka treguar të motrës e cila e ka braktisur këtë A.B. Ai në shenjë hakmarrje ka vrarë të vëllain e ish-të fejuarës tek “Stacioni i Trenit”...”. Në datë 10.11.2017, në artikullin “Dilemat e Edi Ramës si viktimë e shtypit” në mes të tjerash shkruhet se: “...Burri i kësaj gruas nga Tropoja, që është bërë prokurore ‘antikorrupsion’, kërkon për mua dhe kryeredaktorin, dy vjet burg, se gazeta ka botuar intervistën e një personi publik, që e akuzon burrin e kësaj ‘kryevetingares’, se ka qenë i përfshirë në aktivitet prostitucioni...”.

Në ankesë, A.B shpjegon se: “Nga të gjitha publikimet dallohet qartazi karakteri diskriminues dhe denigrues i përdorur nga botuesi M.B dhe kryeredaktori B.L. Në fjalorin e tyre aspak etik, dallohet më së miri gjuha e urrejtjes ndaj Tropojanëve, duke na stigmatizuar si të paaftë, të korrumpuar politikisht, si me boshllëqe vizive dhe fjalori. Në botime fillimisht sulmohet figura e E.I, për të cilën marrë shkas nga origjina krahinore e saj nuk ngurrohet të cilësohet si e “e paaftë”, “ngelëse”, “me boshllëk nga ana vizive dhe fjalori”, etj. Të gjitha këto fyerje dhe shpifje të M.B dhe B.L, janë mjete për të diskriminuar një funksionare publike në ushtrimin e funksionit të saj kushtetues duke e shantazhuar vetëm për shkak të përkatësisë së saj krahinore. Pas këtij momenti nga M.B dhe B.L, për të njëjtin motiv (nga prejardhja) është kaluar në një sulm ndaj A.B, për arsye se është bashkëshorti i funksionares publike. Fjalori i përdorur nga M.B dhe B.L në publikimet e tyre, përhapin një gjuhë urrejtje në popull, pasi krijon opinion dhe përhap idenë

se qënia nga Tropoja, nga i njëjti vend me ish kryeministrin, patjetër që do të ndikojë në ushtrimin e profesionit, dhe sigurisht që edhe personat me këtë origjinë nuk e meritojnë ushtrimin e profesionit të tyre, janë të paaftë, janë trafikantë, vrasës të pamoralshëm. Përsa i përket karakterit dhe përhapjes së publikimeve dhe natyrës diskriminuese të tyre, Gazeta Tema, është e vetmja në versionin, print copy që ka publikuar informacione të tilla, dhe më pas ky lajm është shpërndarë me pa të drejtë në shumë portale online”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit të kryer nga shtetasit M.B dhe B.L.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh³. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh⁴.

Në mungesë të një praktike kombëtare Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së

³ Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”

⁴ Neni 14, I KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”

Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14 i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. **Pretendimi i ankuesit se shkak për diskriminimin e tij është lidhja familjare me E.I që është bashkëshortja e tij me detyrë Prokurore pranë Prokurorisë për Krime të Rënda dhe vendindja e E.I në Tropojë, përbën shkak që gëzon mbrojtje sipas nenit 1 të ligjit.**

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ka parashikuar në Nenin 7/1 se: “*Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim*”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Me shkresën nr.168 prot, date 30.01.2018 është bërë njoftimi dhe i është kërkuar informacion subjektit, M.B dhe B.L, në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim të paraqitur nga A.B dhe E.I.

Palët e interesuara kanë marrë dijeni për shkresën me anë të: Lajmërim marrje poste nr. RR 264159679 AA, RR 264159696 AA dhe RR 264159719 AA datë 02.02.2018 dhe nuk kanë kthyer përgjigje.

III. Vlerësimi i Komisionerit, i fakteve dhe provave të grumbulluara, gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Shqipëria ka nënshkruar Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, e cila në nenin 14⁵, garanton parimin e barazisë dhe detyron shtetet anëtare që të garantojnë gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë pa diskriminim, si dhe Protokollin nr.12 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, i cili

⁵ Neni 14, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore - Ndalimi i diskriminimit “*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër*”.

mbulon çdo të drejtë që garantohet në nivel kombëtar, edhe nëse kjo nuk përfshihet në të drejtat që mbulon Konventa.

Barazia përpara ligjit është një parim kushtetues i sanksionuar në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë⁶.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ndalon diskriminimin që bazohet në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, pra edhe për shkak të vendlindjen dhe lidhjes familjare dhe që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. Në bazë të nenit 3, pika 2 e ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, sanksionohet se një person apo grup personash diskriminohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, kur trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.

Liria e shprehjes, është një e drejtë Kushtetuese e cila garantohet nga neni 22/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kushtetuta sanksionon se të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në të mund të kufizohen. Kushtetuta e lidh kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në të, me detyrimin për të mos tejkaluar kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut⁷. Në këtë aspekt edhe liria e shprehjes nuk mund të jetë absolute. Për këtë arsye, në analizën që i është bërë gjuhës të përdorur nga M.B dhe B.L, nëse ato do të konsideroheshin në tejkallim të lirisë së fjalës të sanksionuar në nenin 22 të Kushtetutës, i jemi referuar kufizimeve që parashikon Konventa për lirinë e shprehjes, të parashikuar në nenin 10 të saj dhe qëndrimin të mbajtur nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Ushtrimi i lirisë së shprehjes përmban në vetvete detyrime dhe përgjegjësi. Sipas paragrafit të dytë të nenit 10 të Konventës, ushtrimi i kësaj lirie nuk mund të çenojë dinjitetin dhe të drejtat e të tjerëve. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka theksuar në gjykime të ndryshme se: *“Toleranca dhe respekti për dinjitetin e barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Duke qenë kështu, si çështje parimore mund të konsiderohet e nevojshme në disa shoqëri demokratike që të sanksionojnë ose madje të parandalojnë të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen e bazuar në jo tolerancë ..., me kusht që çdo “formalitet”, “kusht”, “kufizimet ose gjokat” janë proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur. (Erbakan v. Turkey, Aktgjykimi i 6 korrikut 2006, § 56)”*. Duke qenë kështu lind nevoja e parandalimit të të gjitha formave të

⁶ Neni 18 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: *“Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive”*.

⁷ Neni 17 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen bazuar në mungesën e tolerancës.

Gjuha e urrejtjes për qëllim të Rekomandimit CRI(2016)15 përfshin përdorimin e një ose të disa formave më të veçanta të shprehjes – si psh, mbrojtja, promovimit apo nxitjes së denigrimit, urrejtje apo shpifje të një personi ose grupi personash, si dhe çdo ngacmim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim apo kërcënim i një personi ose disa personave dhe çdo justifikim të të gjithë formave të shprehjes - që është i bazuar në një listë jo shteruese të karakteristikave personale ose statusin që përfshin "raca", ngjyra, gjuha, feja apo besimi, kombësia apo origjina kombëtare ose etnike, si prejardhja, moshja, paaftësia, seksi, gjinia, identiteti gjinor dhe orientimi seksual⁸.

Mbështetur në Rekomandimin 97(20) të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, miratuar në 30.10.1997, “fjalimet e urrejtjes”, përfshijnë të gjitha format e shprehjes të cilat shpërndajnë, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin ose forma të tjera të urrejtjes bazuar në mungesën e tolerancës.

Në artikujt e sipërcituar të botuar në gazetën “TemA”, qëndrimin antitropojan, botuesi dhe kryeredaktori i gazetës “TemA” e justifikojnë me anë të “argumenteve” se të gjithë personat që kanë prejardhje nga Tropoja, janë të “emëruar” në funksione publike sepse kanë lidhje fisnore dhe politike me z.Sali Berisha, janë të paaftë, kanë boshllëqe vizive dhe të fjalorit. Nga ana tjetër në artikujt objekt shqyrtimi nuk është lënë pa përmendur dhe bashkëshorti i E.I duke e etiketuar si të përfshirë në trafik prostitucioni dhe si vrasës. Argumentet e dhëna dhe gjuha e përdorur nga autorët në këto artikuj vlerësohet si përdorim i gjuhës së urrejtjes duke u nisur nga vendlindja e prokurores së përmendur si dhe duke bërë etiketime duke u nisur nga lidhja familjare dhe jeta personale e ankuesve.

Komisioneri nga gjykimi i gjuhës së përdorur në artikujt objekt shqyrtimi, vlerëson se në të gjitha rastet, mbrojtja e reputacionit të subjekteve ankuese dhe në veçanti të E.I si funksionare publike, duhet të ketë përparësi mbi lirinë e medias.

Në çështjen Feret⁹ kundër Belgjikës, GJEDNJ ka bërë interpretime të rëndësishme, nga të cilat citojmë se: “.....nxitja e urrejtjes nuk nënkupton domosdoshmërisht thirrje për kryerjen e akteve të dhunës apo ndonjë akti tjetër të paligjshëm. Sulmet ndaj grupeve të veçanta të popullsisë të kryera nëpërmjet fyerjes, talljes apo shpifjes, mund të jenë të mjaftueshme për autoritetet për të përligjur trajtim të menjëhershëm dhe efikas kundër shprehjeve raciste, përballë lirisë së shprehjes të ushtruar në mënyrë të papërgjegjshme.....”.

Komisioneri vlerëson se gjuha e përdorur nga M.B dhe B.L, për shkak të vendlindjes së E.I dhe lidhjes familjare për A.B, reflekton dukshëm një qëndrim të qëllimtë diskriminues në mënyrë të tillë që cënon rëndë parimin e mosdiskriminimit, në zbatim të ligjit 10221/2010

⁸ ECRI General Policy Recommendation No.15 “On combating hate speech” CRI(2016)15. Adopted on 8 December 2015. B.9 Definition (s).

⁹ Feret kundër Belgjikës, Kërkesa nr/15615/07, 16 korrik 2009.

“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe sulme të tilla ndaj grupimeve të veçanta të popullsisë të kryera përmes fyerjes, stigmatizimit apo shpifjeve janë të mjaftueshme për autoritetet për të përligjur trajtim të menjëhershëm dhe efikas kundër shprehjeve raciste përballë lirisë së shprehjes të ushtruar në mënyrë të papërgjegjshme.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë e ka theksuar këtë fakt në çështjen Feryn¹⁰ ku është shprehur se: “..... mosndëshkimi i një sjelljeje diskriminuese kaq të hapur do të minonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së Direktivës për barazi bazuar në shkaqe raciale”.

Në çështjen Feret¹¹ kundër Belgjikës, GJEDNJ ka mbajtur qëndrimin se: “.....një ligjëratë e tillë në mënyrë të paevitueshme do krijojë mes publikut – e veçanërisht mes atyre anëtarëve të publikut që nuk janë të mirëinformuar – ndjenja keqkuptimi, madje refuzimi e te disa, edhe urrejtje.....”¹²

Rëndësia që merr liria e fjalës për një person publik sjell një përgjegjësi më të madhe, për të treguar më tepër kujdes dhe për të evituar gjuhën që nxit mos tolerancën dhe diskriminimin mes publikut. Lufta kundër mungesës së tolerancës dhe diskriminimit janë thelbësore në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, të drejta dhe liri që përbëjnë një nga bazat e shtetit. Gjithashtu, Komisioneri vlerëson se, përhapja e ligjëratave të tilla nëpërmjet shtypit të shkruar dhe elektronik përbën një mjet të fuqiqëm të përhapjes së informacionit, ashtu si në rastin në shqyrtim që artikujve të botuar në gazetën “Tema” i janë referuar disa portale online dhe janë bërë komente të shumta fyese nga lexues të ndryshëm.

Në parimin 6, të Shtojcës së Rekomandimit nr. (97) 20, theksohet se ligji dhe praktika kombëtare duhet të dallojë qartë përgjegjësinë e autorit të shprehjes të gjuhës së urrejtjes në njërin anë dhe përgjegjësinë e medias dhe profesionistëve të medias, të cilët kontribuojnë në përhapjen, si pjesë e misionit të tyre për të komunikuar informacionin dhe idetë në çështjet e interesit publik, në anën tjetër. Por, në pjesën shpjeguese të rekomandimit theksohet se, kjo nuk do të thotë që mediat dhe profesionistët e medias nuk duhet të ushtrojnë kujdesin e duhur kur publikojnë mbi gjuhën e urrejtjes ose mungesës së tolerancës në përgjithësi. E drejta e individëve, për të shprehur lirisht mendimet e tyre nuk duhet të “fyejë, tronditin apo shqetësojnë” të tjerët¹³.

Në çështjen në fjalë, Komisioneri mban parasysh edhe dy fakte të tjera të rëndësishme që janë, cilësia e M.B dhe B.L si persona publikë dhe mjetin nëpërmjet të cilit janë përhapur artikujt.

Në komentet që kanë shoqëruar artikujt e përmendur nga ankuesit, komentuesit e artikujve kanë shprehur komente fyese dhe denigruese ndaj ankuesve.

Në pikën 1/b, të nenit 17 të Ligjit Nr. 10128, datë 11.05.2009 “Për Tregtinë Elektronike”, parashikohet që: “Kur një shërbim i shoqërisë së informacionit konsiston në ruajtjen e

¹⁰ Centrum voor gelijkheid van kansen en voor racismebestrijding kundër firmës Feryn NV, C-54/07, 10 korrik 2008

¹¹ Feret kundër Belgjikës, Kërkesa nr/15615/07, 16 korrik 2009.

¹² Përkthim i Komisionerit.

¹³ Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, çështja nr. 5493/72, datë 07.12.1976. Përkthim i Komisionerit.

informacionit të siguruar nga marrësi i shërbimit, ofruesi i shërbimit të shoqërisë së informacionit nuk është përgjegjës për informacionin e ruajtur me kërkesën e marrësit të shërbimit, nëse ofruesi i shërbimit: b) me marrjen e këtij informacioni, vepron menjëherë për të hequr ose çaktivizuar aksesin në informacion.”

Duke iu referuar çështjes Delfi AS kundër Estonisë¹⁴, GJEDNJ parashtrroi se: “...GJEDNJ zbuloi se detyrimi për të parandaluar ose hequr komentet e paligjshme dhe sanksioni me 320 euro gjobë të vendosura në kompaninë e aplikantëve nuk kishte përbërë një kufizim të shpërpjestuar në të drejtën e tij për lirinë e shprehjes. Sa i përket përmbajtjes së komenteve, u konstatua se urrejtja dhe kërcënimet e hapura ishin qartësisht të paligjshme - në kuptim të gjuhës së urrejtjes - dhe për këtë arsye nuk kërkonte ndonjë analizë të mëtejshme gjuhësore apo ligjore”.

Në përfundim, nisur nga shqyrtimi i këtyre fakteve, Komisioneri gjykon se, mosmarrja e masave apo veprimeve nga ana e drejtuesve të gazetës TemA, ka sjellë për pasojë edhe vendosjen e ankuesve në kushte të disfavorshme, duke krijuar kështu një mjedis frikësues, përçmues, poshtërues e ofendues.

M.B dhe B.L nuk kanë ofruar asnjë informacion apo pretendim në përgjigje të shkresës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në këtë kontekst, referuar nenit 7, pika 1¹⁵, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, gjykojmë se A.B dhe E.I, janë ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe diskriminues, nga ana e M.B dhe B.L, trajtim i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë, me vendlindjen e E.I dhe lidhjen familjare të A.B.

Në nenin 3/5 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “*“Shqetësim” është ajo formë e diskriminimit që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim apo efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe në rastin e një trajtimi më pak të favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë”*.

Në nenin 3/4 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “*“Diskriminim për shkak të shoqërimit” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur ka një dallim, kufizim ose preferencë, për arsye të shoqërimit me persona që u përkasin grupeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji, si dhe për shkak të supozimit për një shoqërim të tillë”*.

¹⁴ Handbook on European non-discrimination law 2018, fq 88, ECHR, Delfi AS v. Estonia, No. 64569/09, 16 qershor 2015. Përkthim i Komisionerit.

¹⁵ Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 3/5, nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 dhe 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë të shtetasës E.I nga ana e shtetasve M.B dhe B.L për shkak të vendlindjes në formën e shqetësimit.
2. Konstatimin e diskriminimit në formën e shoqërimit dhe shqetësimit të shtetasit A.B nga ana e shtetasve M.B dhe B.L.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

(shkaku: vendlindja)

(Fusha: të mira dhe shërbime)